

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët Shukri Sylejmani kryetar, Isa Kelmendi dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B. G. nga ..., kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), për shkak të kontesti të punës, duke vendosur sipas revizionit të paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4936/2015 datë 28.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 07.02.2019 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4936/2015 datë 28.09.2018.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4936/2015 datë 28.09.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3063/2011 datë 28.08.2015, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit që të anulohet vendimi i të paditurës nr.2533 i datës 14.11.2011 dhe vendimi nr.424 i datës 01.11.2011, me të cilin paditësit i është shkëputur kontrata e punës me numër 8838/0, dhe të obligohet e paditura që paditësin ta kthej në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës si dhe t'ia paguaj të ardhurat personale dhe të ardhurat tjera sikur të ishte në marrëdhënie pune, nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në kthimin e tij në punë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të ndryshohen të dy aktgjykimet e

lartpërmendura dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar ose që të njëjtat aktgjykime të prishen dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

E paditura në përgjigje të revizionit ka kontestuar në tërësi revizionin e paditësit dhe ka propozuar që revizioni të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK) shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se :

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka qenë në marrëdhënie të përhershme pune tek e paditura në detyrat e punës manipulues i kabinës 2-E në Departamentin e prodhimit të thëngjillit. Duke u bazuar në fletëparaqitjen disiplinore nr. ..., të datës 03.11.2011, e paditura me vendimin nr..., të datës 11.11.2011 paditësit i ka ndërprerë marrëdhënien e punës për shkak të shkeljes së rëndë të detyrave të punës, vjedhje e pasurisë së të paditurës. Paraprakisht me vendimin nr..., të datës 31.10.2011, paditësi së bashku me një punëtor tjetër, është suspenduar-larguar përkohësisht nga puna për të njëjtin veprim të pajuar, dhe pas zhvillimit të procedurës disiplinore, siç u tha më lartë, paditësit i është shqiptuar masa disiplinore, shkëputje e kontratës së punës, me çka paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Me këtë vendim paditësi është shpallur përgjegjës sepse më datë 10.10.2011 rreth orës 20,30 minuta, me telefon celular i ka ftuar pjesëtarët e sigurimit fizik të objektit “ B. S.”, M. B., dhe B. N., prej të cilëve ka kërkuar që në hyrje zyrtare të mos e ndalojnë H. H., i cili po ashtu është suspenduar nga puna, i cili ka drejtuar Landroverin me numër intern ..., me të cilin ka transportuar dy kanistera nga 20 litra naftë, dhe për këtë shërbim iu ka ofruar nga 5 € si kompensim. Marrëveshja është arritur ashtu që nafta është dërguar në fshatin Hade, në shtëpinë e vëllait të paditësit B.G. , prej të cilit Policia e Kosovës ka konfiskuar sasinë e lartpërmendur të naftës. E paditura ka konsideruar se me këtë paditësi ka kryer shkelje të rëndë të detyrave të punës nga neni 7 paragrafi 1 pika f, të Kodit Disiplinor të paditurës. Kundër këtij vendimi paditësi ka paraqitur ankesë e cila me vendimin tjetër të paditurës të datës 30.11.2011 është refuzuar si e pabazuar. Paditësi me padinë e paraqitur në gjykatë kërkon që të anulohen të dy vendimet e lartpërmendura të paditurës dhe paditësi të kthehet në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit dhe vlerësimit të provave ka gjetur se sipas nenit 10.21 të Kodit Disiplinor të paditurës, masa disiplinore për shkelje të rënda të detyrave të punës është shkëputja e kontratës së punës, kështu që vlerëson se vendimi i të

paditurës për shkëputjen e kontratës së punës nuk është i kundërligjshëm nga se është marr në pajtim me aktin juridik të paditurës si dhe me nenin 85 paragrafi 1.5 dhe 3, të Ligjit të Punës.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë . Për më tepër, gjykata e shkallë së dytë ka vlerësuar se pretendimet ankimore të paditësit se ai nuk ka qenë kryes i vjedhjes së naftës por se nafta është gjetur në shtëpinë vëllait të tij B. G., i ka vlerësuar si të pa bazuara pasi që këto pretendime bien në kundërshtim me vetë deklaratimet e paditësit në procedurë disiplinore ku e pranon se ka biseduar në telefon me pjesëtarët e sigurimit “B. S.” ashtu siç përshkruhet edhe në vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punë, kështu që e njëjta gjykatë gjen se me veprimet e paditësit vërtetohet lidhja kauzale në mes veprimeve të tij të pa lejueshme dhe shkeljes ligjore që ka ndodhur.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me refuzimin si të pabazuar të kërkesëpadisë së paditësit, pas që aktgjykimet e lartpërmendura nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat në kuptim të nenit 215 të LPK, gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Së këndejmi, u refuzuan si të pabazuara pretendimet e revizionit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n, të LPK, sipas të cilave aktgjykimet e goditura nuk mund të ekzaminohen, nga se janë në kundërshtim me vetveten dhe me arsyetimin e tyre, nuk përmbajnë arsye për faktet vendimtare ose ato që janë paraqitur janë kontradiktore dhe ka kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimeve thuhet për përmbajtjen e dokumenteve ose të procesverbaleve për thëniet e dhëna në procedurë dhe vetë atyre dokumenteve dhe procesverbaleve. Po ashtu në revizion theksohet se dispozitivi i këtyre aktgjykimeve është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me arsyet e aktgjykimit.

Pretendimet e lartpërmendura të revizionit janë të pabazuara për faktin se vetëm në mënyrë të përgjithshme thuhet se aktgjykimet e gjykatave përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182.2 pika n të LPK, duke përshkruar në tërësi tekstin e kësaj dispozite ligjore, pa u sqaruar konkretisht në të metat dhe pa qartësitë e këtij aktgjykimi, si të gjykatës së shkallës së parë po ashtu edhe të gjykatës së shkallës së dytë.

Aktgjykimet e lartpërmendura nuk përfshihen me të meta e pa qartësi në asnjërën pjesë të tyre, dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet juridikisht relevante për vendosje të drejtë në këtë çështje juridike, andaj kjo gjykatë konstaton se janë të pa bazuara thëniet në revizion përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale.

Lidhur me kundërshtimet e revizionit se paditësi ka qenë në pushim e jo në punë ditën kur është kryer shkelja e detyrave të punës, se dy kanistera me naftë janë gjetur në shtëpinë e vëllait të paditësit e jo në shtëpinë e paditësit, gjykata e shkallës së parë dhe e dytë kanë dhënë arsye të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit, të cilat është e pa nevojshme edhe tani të përsëritën. Për më tepër këto pretendime lidhen me gjendjen faktike për të cilin shkak revizioni nuk mund të paraqitet në kuptim të nenit 214.2 të LPK.

U refuzuan si të pa bazuara edhe pretendimet e revizionit se në shkresat e lëndës nuk ka aktgjykim penal të formës së prerë lidhur me atë se paditësi ka bërë vepër penale të vjedhjes, andaj sipas paditësit vendimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës është i pa ligjshëm. Këto pretendime janë të pa bazuara për faktin se vjedhja e pasurisë së të paditurës është sanksionuar me nenin 7.1 pika f, të Kodit Disiplinor të paditurës, dhe e paditura nuk ka pasur as një detyrim që për ndërprerje të marrëdhënie të punës eventualisht të pretë epilogun e zhvillimit të procedurës penale kundër paditësit. Andaj gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, pas që ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditësit nuk është përfshirë me shkelje dhe pa rregullsi materiale dhe procedurale.

Për arsyet e paraqitura më lartë, revizioni i paditësit u refuzua si i pabazuar, andaj në kuptim të nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.2/2019 datë 07.02.2019

Kryetar i kolegjit
Shukri Sylejmani

